

APD, janar – mars 2018:

më shumë se 40 % e mallrave nisen për eksport me anije dhe tragete

16 prill 2018



Që nga fillimi i këtij viti më shumë se 40 përqind e mallrave të përpunuara në portin e Durrësit i përkasin eksporteve.

Sipas të dhënave të Sektorit të Statistikave në APD, gjatë 3-mujorit janar-mars 2018 nga anijet dhe tragetet janë përpunuar në kalata mbi 894 mijë ton mallra të ndryshme gjithsej, ose afro 107 mijë ton më shumë se sa e njejta periudhë e vitit të kaluar. Në tre Terminalet e Mallrave gjatë 3 muajve të parë të këtij viti janë përpunuar 131 anije, ndërsa 224 tragete janë përpunuar në Terminalin përkatës. Mallrat e eksportit të përpunuara në portin e Durrësit kanë patur një rritje prej 20 përqind gjatë periudhës 3-mujore.

Nga të dhënat e Sektorit të Statistikave në APD mësohet se 40.11 përqind e mallrave të përpunuara në kalatat e portit më të madh të vendit nga anijet dhe tragetet i përkasin eksporteve, ndërsa në të njejtën periudhë të vitit të kaluar kjo shifër arrinte në 37.83 përqind.

Sasia më e madhe e mallrave për eksport është përpunuar me kontejnerë. Thuhet gjysma, 49.72 përqind nga më shumë se 412 mijë ton mallra të ngarkuara në kontejnerë, i janë drejtuar porteve të tjerë të Mesdheut e më gjerë.

